

NJOFTIM PUBLIK

Për çeljen e aplikimeve për programin social të strehimit për subvencionimin e interesave të kredisë për vitin 2025

Bashkia Fier, në kuadër të programeve sociale të strehimit, programit të strehimit **për subvencionimin e interesave të kredisë për vitin 2025**, për familjet që do të përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti, për banesa me kosto të ulët në bazë të numrit të familjeve që do të përfitojnë të miratuar për Bashkinë Fier , në përputhje me procedurat administrativo-ligjore të parashikuara në ligjin nr.22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar , VKM nr.384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo program social të strehimit, dhe afateve e procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, Vendim nr. 453, datë 3.7.2019 për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti:

njofton të gjithë familjet e pastreha të interesuara se duhet të plotësojnë kërkesën e tyre në portalin e-albania duke zgjedhur shërbimin “kërkesë për të përfituar nga programet e strehimit social “ si dhe familjet e pastreha të cilat kanë aplikuar për këtë program të shprehin sërish interesin e tyre për të përfituar. Bazuar në kërkesat ligjore nga familja aplikuese /kërkuese duhet të plotësohet dhe ngarkohet dokumentacionin ligjor si më poshtë vijon:

Pasi të bëhet Aplikimi në e-albania :Kërkesë për të përfituar nga programet e strehimit social.

- Fotokopje e kartave të identitetit
- certifikatë e lindjes së aplikantit, me përjashtim të rasteve specifike kur individ/familja nuk ka regjistrim në gjendjen civile;
- certifikatë familjare;
- vërtetim për vendbanimin në njësinë e vetëqeverisjes vendore, ku kërkohet strehimi social,
- vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për pronat që disponohen në emër të secilit anëtar të familjes
- vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme që nuk ka kryer transaksione financiare për tjetësimin e pasurisë në 5 vitet e fundit
- vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për sipërfaqen e pronës, që zotëron familja apo ndonjë anëtar i saj, kur banesa është me sipërfaqe nën normat e strehimit në fuqi;
- vërtetim nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme se nuk figuron e regjistruar asnjë pronë, e cila mund të përdoret edhe për strehim, për çdo anëtar të familjes, që kanë ndryshuar vendbanim për efekt punësimi; Vërtetimi nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës që aplikanti apo cdo pjesëtar tjetër i familjes në moshë madhore nuk ka aplikuar për legalizim banese.

- aktverifikim nga njësia vendore për: – banesat në rrezik shembjeje; – rastet kur familja ka mbetur e pastrehë, si rezultat i fatkeqësive natyrore; – banesat që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit.
- Vendim i gjykatës për familjet që humbasin banesën për shkak të zbatimit të vendimit të gjykatës;
- akt i verifikimit nga njësia vendore për familjet rome/egjiptiane, që banojnë në banesa individuale ose struktura, të cilat nuk klasifikohen si banesë.
- vendim i gjykatës që i lë në ngarkim fëmijën ose fëmijët për çiftet e divorcuara.
- vërtetim i komisionit mjekësor të përcaktimit të aftësisë së kufizuar për individë me aftësi të kufizuara;
- vërtetim përkatës nga institucioni ku ka qënë i strehuar dhe librezë e jetimit, dhënë nga institucioni shtetëror i autorizuar për individët me statusin e jetimit;
- dokument që vërteton se ka mbetur i pastrehë si rezultat i lirimimit të banesave, ish-pronë e subjekteve të shpronësuara;
- dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për personat që kanë statusin “emigrant”, “punëtor emigrant” dhe “azilkërkues”;
- dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për familjet e punonjësve të rënë në detyrë, që u përkasin Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të shtetit dhe të Policisë së Burgjeve;
- vetëdeklarim nëse individi/familja i përket pakicës kombëtare rome ose egjiptiane;
- dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse për të miturit në konflikt me ligjin;
- vetëdeklarim se i përket grupimit LGBTI;
- vërtetim me certifikatë familjare se individi i përket kategorisë vajzë-nënë.
- vërtetim i të ardhurave neto të familjes ose një deklaratë me shkrim nga aplikuesi për të ardhurat e familjes dhe burimin e tyre, të cilat duhet t’i bashkëlidhen dokumenteve zyrtare që e vërtetojnë atë, përfshirë vërtetimin nga punëdhënësi për pozicionin dhe pagën e aplikantit e të personave të tjerë të familjes, që janë në marrëdhënie pune;
- vërtetim page dhe pozicioni për personat e familjes që janë në marrëdhënie pune;
- vërtetim nga organet tatimore dhe ato të sigurimeve shoqërore për derdhjen e kontributeve, për

të gjithë anëtarët e punësuar dhe të vetëpunësuar të familjes;

- vërtetim nga zyra e ndihmës dhe përkujdesjes pranë njësive të vetëqeverisjes vendore për anëtarët e familjes të përfshirë në programin e ndihmës ekonomike dhe të pagesës për personat me aftësi të kufizuara;

- vërtetim nga zyra e punësimit e njësive vendore përkatëse për personat e përfshirë në programin e pagesës së papunësisë;

- vërtetim nga organet e sigurimeve shoqërore për personat në pension;

· vërtetim nga organet tatimore nëse pjesëtarët e familjes ushtrojnë aktivitet privat

- dokumentacion ligjor mbi kushtet e strehimit duke dhënë informacion të saktë se ku jeton kontratë qiraje / deklaratë noteriale me informacion në përgjegjësinë ligjore të aplikuesit mbi kushtet e strehimit aktual

***Afati i aplikimit, nga data 20/12/2024 deri në 20/01/2025.**

***Dokumentat duhet të jenë të lëshuar brenda 3 muajve të fundit nga momenti që familja/aplikuesi bën aplikimin/ ndërsa nga familjet që kanë aplikuar për këtë program dhe që do rishfaqin interes duhet të bëhet rifreskimi i dokumentacionit ligjor përkatës .**

Pranë , Bashkisë Fier , Zyrës me një ndalëse mirëpret për sqarim dhe ndihmesë të gjitha familjet e interesuara .